



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 02.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas dy **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 31.03.2025 të parashtruar nga operatori ekonomik Albkos Safety Sh.p.k. nga Fushë Kosova, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Servisimi i pajisjeve kunder zjarrit ne ISSH”** me nr. prokurimi **206-25-941-2-2-1**, nxjerr:

**V E N D I M**

- I. **Pranohet**, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik Albkos Safety Sh.p.k. e datës 31.03.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Servisimi i pajisjeve kunder zjarrit ne ISSH”** me nr. prokurimi **206-25-941-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 25.03.2025, të publikuar në platformën elektronike;
- II. **Anulohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 25.03.2025;
- III. Autoriteti Kontraktues, e kthen në Rivlerësim aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik Albkos Safety Sh.p.k. me datën 31.03.2025 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Servisimi i pajisjeve kunder zjarrit ne ISSH”** me nr. prokurimi **206-25-941-2-2-1**. Autoriteti Kontraktues, me datë 02.04.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

**Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:**

Neni 1 – Qëllimi

Neni 59 – E kzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës

### Pretendimet ankimore

Nuk pajtohem me vendimin e AK për eliminimin e Albkos Safety Sh.p.k. nga aktiviteti i prokurimit, dhe anulimin e aktivitetit të prokurimit me arsyetimin, siç shihet më poshtë:

"Ministria e Shëndetësisë anulon' AP për arsye se dy ofertat te pranuar nuk janë te përgjegjshme. Ofertat e dy OE janë vetëm për një servisim d.m.th. për gjashte muaj, ndërsa duhet te jene për 36 muaj.

Bazuar ne paragrafin 1.1 te nenit 62 te LPP-se ky aktivitet duhet te anulohet dhe gjate ritenderimit do te korrigohet sasia për 36 muaj" .

#### PRETENDIMI ANKIMOR 1:

AK në dosjen e tenderit nuk e kishte përcaktuar nëse për çmimet për shërbimet e kërkuara duhet të jepen **çmim për (1) një servisim** apo **për të gjitha servisimet** brenda periudhës së kontratës.

Prandaj, më 28.03.2025 kemi kërkuar informata shtesë dhe, po atë ditë, AK kishte sqaruar se **"çmimi duhet të prezantohet për një (1) njësi apo servisim dhe kontrata duhet te jetë për 36-muaj dhe servisimi do të behet sipas kërkesave të institucionit"** dhe ne kemi ofertuar saktësisht sipas udhëzimeve të AK.

Duke qenë se vendimi i AK është marrë në kundërshtim me LPP, kërkojmë nga AK të anuloj njoftimin mbi anulimin e Albkos Safety nga aktiviteti i prokurimit dhe anulimin e kontratës, të kthejë lëndën në rishqyrtim dhe të shpërblejë me kontratë Albkos Safety duke qenë operator i përgjegjshëm më çmimin më të ultë.

#### Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE ankues:

Pajtohem me pretendimin e juaj ankimor dhe me këtë rast dhe ju njoftojmë se ka ndodhur një paqartësi ne mes prokurimit dhe Njësisë se Kërkesës gjate hartimit te dokumentacionit, andaj me vonese i kemi vërejtur disa detaje.

Me vendimin tone - Njoftimin mbi Vendimin e AK te datës 25.03.2025, ne e kemi pare me te drejte qe lenden ta përsërisim dhe gjate ritenderimit te korrigojen defektet, por duke marre parasysh se vendimi ynë ka edhe defekte teknike, si çmimi i ofertes tuaj ne vend qe te shënohet 409.46 euro eshte shënuar 904.46 euro, gjithashtu sipas Letër standarde B46 dy ofertat janë njoftuar si te pasuksesshme, ndërsa ne B58 gabimisht eshte përshkruar se dy ofertat te pranuar nuk janë te përgjegjshme.

E konsiderojmë te drejte qe lënda te kthehet ne rivlerësim duke marre parasysh qëllimin e aktivitetit, vlerën jo te madhe dhe faktin se gjate fazës se tenderimit me datën 28.02.2025 janë dhënë sqarime shtese pikërisht për çështjen e pretenduar, me arsyetimin sipas Njësisë se Kërkesës se **"Sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës, në lidhje me servisimin e aparateve për shuarjen e zjarrit, duke marrë parasysh se ky servis duhet të kryhet çdo gjashtë (6) muaj çmimi duhet të rezantohet për një (1) njësi apo servisim dhe kontrata duhet te jetë për 36-muaj dhe servisimi do të behet sipas kerkesave të institucionit pasi qe mund te ket edhe raste emergjencash e qe nevojitet funksionalizim I këtyre paisjeve"**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

#### Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit te këtij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit